

**AKTI THEMELIMIT DHE STATUTI**  
**I**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“KUJTIMI BUS” SHPK.**

Sot me date **06.08.2020**, ne baze te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, me vullnetin e tij te plote dhe te lire, ortaku i vetem themelues i Shoqerise:

**1. Z. Alfred Gjoni**, lindur ne **Vilëz**, i datelindjes **27-06-1980** dhe me banim ne **Tirane – Shqiperi**, shtetas Shqiptar, madhor me zotësi te plote juridike për të vepruar, i identifikuar me pasaporte nr. personal **I00627126W**.

**2. Z. Bruno Gjyla**, lindur ne **Lushnje**, i datelindjes **07-09-1995** dhe me banim ne **Lushnje-Shqiperi**, shtetas Shqiptar, madhor me zotësi te plote juridike për të vepruar, i identifikuar me pasaporte shqiptare nr. personal **J50907137V**.  
Miratojne statutin e shoqerise si vijon.

**EMERTIMI – SELIA – OBJEKTI - KOHEZGJATJA**

**NENI 1**  
**EMERTIMI**

- 1.1 Emertimi i shoqerise eshte **“KUJTIMI BUS”** Sh.p.k. (ne vijim e quajtur **“Shoqeria”**).
- 1.2 Shoqeria fiton personalitet juridik ne momentin e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar Shqiptar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.
- 1.3 Shoqeria ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, me Statutin dhe me Aktin e Themelimit.

**NENI 2**  
**SELIA**

- 2.1 Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen **Lagjia Loni Dhamo, Stacioni i Trenit, Objekt 1 - katesh Nr. 1**.
- 2.2 Shoqeria mund te hape dege, zyra perfaqesie dhe te krijojë filiale ne qytete te ndryshme te Republikës se Shqiperise dhe/ose jashte saj.

**NENI 3**  
**OBJEKTI**

Shoqeria ka per objekt:

- Transport udhetaresh brenda dhe jashte vendit per vete dhe te trete. Agjenci turistike. Agjenci udhetimesh. Import-eksport, tregti te artikujve te ndryshem. Operator turistik. Ne fushen e turizmit, hotclerise, shitje / blerje biletash avioni, trageti, autobusi dhe/apo te mjeteve te ndryshme te organizimit e formave te udhetimeve turistike, udhetime pune etj. Shitje / blerje te paketave turistike, evenimenteve zyrtare dhe jo-zyrtare, organizim konferencash, seminaresh. Udhetime Turistike me grupe te organizuara brenda dhe jashte vendit. Shitje



blerje biletash per evente sportive dhe evenimente te ndryshme kulturore dhe artistike. Makina me qera, siguracion shendeti ne udhetim. Organizim turesh brenda dhe jashte vendit. Pushime dhe udhetime me kroçiera. Shoqeria bashkepunon me agjenci te tjera turistike, udhetimi, shoqeri transportesh etj, vendase dhe / apo te huaja, hotele, resorte, restorante, individe, familje etj, qe kane objekt veprimtarie te njejte me te apo qe lidhen me objektin e saj te veprimtarise. Shoqeria do te kryeje aktivitet ne fushen e promovimit te turizmit vendas e te huaj, 2 bashkepunim me agjenci, persona juridike, fizike, individe, institucione te ndryshme shteterore / publike / private, etj; Shoqeria organizon ture te ndryshme te permasave te ndryshme ne pjese marrje, objektiv udhetimi, qellime udhetimi. etj, te ndryshme, brenda dhe jashte vendit, ne perputhje me legjislacionin e RSH dhe ate nderkombetar. Shitje te produkteve te agjensise (bileta avioni, bileta autobusi, makina me qera, transfertat, eskursionet, rezervime apartamentesh dhe hotelesh, udhetime turistike

#### NENI 4 KOHEZGJATJA

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj pa afat. Asambleja e Ortakeve me vendim mund te vendose nje afat per kohezgjatjen e Shoqerise.

#### KAPITALI - TRANSFERIMI I KAPITALIT

##### NENI 5 KAPITALI

5.1 Kapitali i shoqërisë tregtare private “KUJTIMI BUS” Sh.p.k., do te jete 100.000 Leke (njqindmije).

Kapitali ne para eshte nenshkruar nga ortakët e shoqerise themelues si vijon:

1. **Z. Alfred Gjoni**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 51.000 (pesedhjet e njemije) Leke qe perben 51% (pesedhjet e nje) te kapitalit themeltar te shoqerise.
2. **Z. Bruno Gjyla**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 49.000 (dyzet e nentemije) Leke qe perben 49% (dyzet e nente) te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme ose te paluajtshme/ te drejta).

5.2 Përgjegjësia e ortakëve për detyrimet e Shoqerise shtrihet deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin e Shoqerise.

##### NENI 6 TRANSFERIMI I KAPITALIT

6.1 Kuotat e shoqerise jane te transferueshme ne çdo rast vetem me miratimin e asamblese se ortakëve dhe ortakët kane te drejten e parablerjes ne proporcion me kuotat qe zoterojne.



6.2 Ortaket qe deshirojne te transferojne te gjitha kuotat e tyre ose pjese te tyre, duhet te njoftojne oferten me ane te letres me poste te regjistruar Administratorit te Shoqerise. Kjo oferte duhet te permbaje te dhenat personale te shitesit dhe kushtet e transferimit, dhe ne vecanti çmimin dhe menyren e pageses. Administratori, duhet t'i komunikojte oferten, brenda 30 diteve nga marrja e njoftimit, ortakeve te tjere te cilet duhet te ushtrojne te drejten e parablerjes. Çdo ortak i interesuar per blerjen duhet te njoftoje Administratorin per ushtrimin e te drejtes se parablerjes brenda 30 diteve nga marrja e njoftimit te Administratorit. Pjesa e kapitalit duhet te transferohet brenda 30 diteve nga data qe Administratori i ka njoftuar ortakut transferues pranimin e ofertes se tij duke treguar dhe ortaket qe e kane pranuar ate. Ne rast se ortaket nuk njoftojne Administratorin brenda 30 diteve per blerjen ose e refuzojne ate, ortaku ofertues ka te drejte te shese kuotat e tij ndaj te treteve dhe asambleja eshte e detyruar ta miratoje.

## ASAMBLEJA E ORTAKEVE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

### NENI 7 ASAMBLEJA E ORTAKEVE

#### Funksionet dhe Kompetencat

7.1 Ne perputhje me legjislacionin Shqiptar, Asambleja e Ortakeve, e thirrur rregullisht perfaqeson te gjithë ortaket dhe eshte organi me i larte vendimmarres.

Vendimet e asamblesë se përgjithshme merren ne formën e vendimeve me shkrim.

Procesverbali i vendimeve duhet t'i dorëzohet administratorit, i cili e regjistron ne regjistrin e vendimeve, qe do te ruhet ne selinë ligjore te shoqërisë nen kujdesin e administratorit.

Asambleja e përgjithshme mund te mblidhet edhe jashtë territorit te Republikës se Shqipërisë për çfarëdolloj vendimi. Ne këtë rast vendimet e asamblesë se përgjithshme te marra jashtë territorit te Republikës se Shqipërisë, do t'i nënshtrohen procedurave te parashikuara nga ligji shqiptar për njohjen e dokumenteve te huaja ne Shqipëri.

7.2 Asambleja e Ortakeve vendos, por pa u kufizuar, mbi:

- (a) ndryshimin e statutit;
- (b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- (c) emerimin dhe shkarkimin e likuidatoreve dhe ekspertet kontabel;
- (ç) miratimin e shperblimit te administratoreve, likuidatoreve dhe ekspertet kontabel;
- (d) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga Administratoret perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- (dh) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- (e) zmadhimin dhe zvogelimin i kapitalit;
- (ë) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- (f) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne proçedimet e tjera ndaj administratoreve;
- (g) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- (gj) miratimin e rregullave proçedurale te mbledhjeve te asamblese;
- (i) miratimin e shperndarjeve te fitimeve;
- (j) shfuqizimi i ndalimit te konkurrences;
- (k) pezullimi i aktivitetit te shoqerise.

7.3 Kuorumi i nevojshëm për të vendosur në asamble është pjesëmarrja e ortakeve me të drejtë vote që zoterojnë të paktën 50% të kuotave të kapitalit që me pas vendosin me 3/4 e votave për çështjet që kërkojnë shumicë të zakonshme, me përjashtim të pikës 7.2/b për të cilën vendosin sipas nenit 95/6 të ligjit nr. 9901/2008 dhe në rast të atyre që kërkojnë shumicë të kualifikuar si, por pa u kufizuar vetëm në keto, rritja dhe zvoglimi i kapitalit, ndryshimi i statutit, prishja ose shndërrimi i shoqërisë, transferimi i kuotave, shfuqizimi i ndalimit të konkurrencës, kuorumi i nevojshëm është pjesëmarrja e ortakeve me të drejtë vote që zoterojnë 3/4 e kuotave të kapitalit të shoqërisë dhe vendosin me unanimitet.

7.4 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble në mënyrat e parashikuara nga ligji sipas paragrafit më poshtë dhe mund të përfaqësohet edhe nga persona që nuk janë ortake. Akti i përfaqësimit duhet të jetë me shkrim dhe të tregojë emrin e përfaqësuesit. Akti i përfaqësimit duhet të leshohet vetëm për një asamble e cila përfshin edhe mbledhjet pasardhëse të Asamblese së Ortakeve me të njëjtin rend dite. Asambleja e Ortakeve kryesohet nga Administratori i Vetëm, ose në mungesë të tij nga një person i emëruar në moment.

#### Vendi i mbledhjeve

7.5 Asambleja e Ortakeve mbledhet në Shqipëri dhe jashtë territorit të saj, ashtu siç tregohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblese së Ortakeve.

7.6 Mbledhjet e Asamblese së Ortakeve mund të zhvillohet edhe me mjetet elektronike si audio konferencë dhe video konferencë me kusht që: (a) që të jenë të pranishëm në të njëjtin vend kryetari dhe sekretari i mbledhjes, në rast se është emëruar, të cilët do të përpilojnë dhe nënshkruajnë procesverbalin meqenëse mbledhja do të konsiderohet e mbledhur në vendin ku janë ata; (b) t'i mundësohet kryetarit të mbledhjes të verifikojë identitetin e personave që marrin pjesë në mbledhje, të verifikojë rregullsinë e mbledhjes, që të verifikojë dhe të shpallë rezultatet e votimeve; (c) t'i mundësohet sekretarit që të marrë në mënyrë të rregullt çdo nderhyrje objekt i procesverbalit; (d) t'i mundësohet pjesëmarrësve në mbledhje që të diskutojnë dhe të votojnë në kohë reale mbi rendin e ditës, si dhe të shqyrtojnë, të marrin dhe të transmetojnë dokumenta. Vendimet e mbledhjeve do të regjistrohen në procesverbal të nënshkruar nga kryetari dhe sekretari i emëruar në asamble.

#### Njoftimi i Asamblese së Ortakeve

7.7 Asambleja e Ortakeve thirret të paktën një herë në vit në rastet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar mbi shoqëritë tregtare. Administratori ose ortaket që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të shoqërisë, në bazë të dispozitës së nenit 84 të ligjit nr. 9901 del 14.04.2008, thërresin Asamblenë e Ortakeve. Asambleja e përgjithshme mbledhet me një lajmërim të dërguar nga administratori ortakeve me shkrim, ose sipas zgjedhjes së administratorit i dërguar me postë elektronike të paktën 7 ditë përpara datës së fiksuar për Asamblenë e Ortakeve dhe duhet të përmbajë rendin e ditës, orën dhe vendin e mbledhjes. Vendimet e Asamblese së Ortakeve duhet të regjistrohen në procesverbal.

### NENI 8

#### ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

8.1 Shoqëria administrohet nga një Administrator i vetëm i emëruar nga Asambleja e Ortakeve. Administratori i Shoqërisë është:

**Z. Alfred Gjoni**, lindur në **Vilëz**, i datelindjes **27-06-1980** dhe me banim në **Tiranë - Shqipëri**, shtetas Shqiptar, madhor me zotësi të plote juridike për të vepruar, i identifikuar me pasaportë nr. personal **I00627126W**.



Administratori emerohet per nje periudhe 5 (pese) vjecare me te drejte ripertesitje dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Administratori ka tagra te **pakufizuara**. Me titull thjeshtues por jo gjithepershires, ne menyre te veçante ushtron keto tagra:

- administron Shoqerine ne zbatim te politikave tregtare te percaktuara nga asambleja e ortakeve;
- perfaqeson shoqerine;
- emeron perfaqesues te pergjithshem ose te posaçem per çeshtje te veçanta dhe vendos mbi shkarkimin e tyre;
- kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise;
- pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, raportin mbi ecurine e veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve i paraqet ne Asamblene e Ortakeve per miratim;
- kryen regjistrimet e detyrueshme te parashikuara nga regjistri tregtar;
- informon Asamblene e Ortakeve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e Shoqerise;
- pranimet ne pune, pagat, largimet nga puna, masat disiplinore për vartësit, miratimin e kërkesave për largim nga puna;
- te emeroj financiar e konsulentë për problemet e shoqërisë. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare, tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore për aktivitetin e kryer nga shoqëria;
- te lidhi marrëveshje me te trete ne kufijtë e objektit te aktivitetit te shoqërisë dhe te kompetencave te percaktuara nga ortaket;
- te shpërblehet për punën qe kryen sipas marrëveshjes me ortaket themelues.
- te thërrasi asamblenë e përgjithshme, sipas dispozitave te përcaktuara ne ligj;
- te kryej veprime/tranzaksione ne llogarite rrjedhese te shoqerise me vlera te pakufizuara, perfshire nenshkrimin e kontratave me te trete.

**8.2** Administrimi i shoqerise me vendim te asamblese se ortakeve mund te behet dhe nga nje ose me shume administratore te cilet mund ta administrojne se bashku ose veçmas shoqerine sipas vendimit perkates te asamblese.

**8.3** Administratori shkarkohet nga detyra nga asambleja e ortakeve ne rastet si me poshte:

- shkarkohet nga asambleja per shkak se nuk permbush detyrat qe i jane caktuar nga statuti dhe ligji, ben mungesa te pajustificuara per me shume se tre muaj ose nuk eshte me i afte per t'i permbushur ato;

- jep doreheqjen dhe j'a komunikon ate asamblese, jo me vone se 30 dite para dates se largimit.

## NENI 9 KONTROLI KONTABEL

Nese kerkohet nga ligji, eksperti dhe/ose ekspertet emerohen nga Asambleja e Ortakeve. Asambleja e Ortakeve mund te riemeroje te njejtin/et ekspert/e. Eksperti/et shkarkohet/n nga detyra me vendim te Asamblese se Ortakeve ne rast mosrespektimi te detyres se tij, ne rast gabimi dhe ne rast mungese profesionalizmi ne sjellje, ose kur Asambleja e Ortakeve e konsideron te arsyeshme sipas gjykimit te saj.

**NENI 10**  
**VITI USHTRIMOR - PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE**

10.1 Viti financiar i shoqerise fillon me 1 janar dhe mbyllet me 31 dhjetor te çdo viti. Perjashtimisht per vitin e themelimit te Shoqerise, viti financiar fillon ne daten e themelimit dhe mbllet me 31 Dhjetor 2017.

10.2 Ne rast prishje dhe likuidimi te Shoqerise, ne çdo moment dhe per çdo arsye, emerimi i likuidatorit do te miratohen me vendimin e Asamblese se Ortakeve sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

**NENI 11**  
**FITIMI DHE DIVIDENTET**

Fitimet qe rezultojne nga bilanci i miratuar rregullisht, pasi te jene zbritur paraprakisht shumat e destinuar per rezerven ligjore, me vendim te Asamblese se Ortakeve, mund te vendosen ne rezerve ose te shperndahen.

**NENI 12**  
**DISPOZITA TE ZBATUESHME**

12.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj tregtar ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me kete statut. Per çeshtjet e parregulluara ne kete Statut do te zbatohet Ligji nr. 9901 del 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar.

12.2 Per çdo mosmarreveshje qe mund te lindet ne lidhje me zbatimin dhe interpretimin e ketij statuti, si dhe çdo mosmarreveshje qe lind ndermjet Shoqerise dhe ortakeve, ose ndermjet ortakeve do te zgjidhen fillimisht me ndermjetesim ligji nr. 10835/2011, ne rast se nuk nenshkruhet nje marreveshje ndermjetesimi atehere palet bien dakord qe te jete kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

**NENI 13**  
**NDRYSHIME**

Ky Statut mund te ndryshohet, te zevendesohet, te rishikohet ose te zevendesohet ne teresi nga nje Statut tjeter te miratuar me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Ky Statut hartohet ne 4 (kater) kopje ne gjuhen italiane dhe ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe te gjitha me vlefshmeri te njejte, me perjashtim ne rast interpretimi, ku versioni ne gjuhen italiane do te mbizoteroje mbi ate shqipe.

**Ortaket e shoqerise**

1. Z. Alfred Gjoni
2. Z. Bruno Gjyla

Alfred Gjoni  
Bruno Gjyla

